

EPPC Albania kërkon një **Menaxher Sektori (Background Inxhinierik)** për klientin e saj, i cili operon prej 25 vitesh në vend, në sektorin e tregëtisë së materialeve elektrike, pajisjeve elektronike dhe telekomunikacionit.

Përgjegjësitë kryesore:

- Planifikon blerjen e produkteve në përputhje me kërkesat duke garantuar vazhdueshmërinë e inventarit;
- Bën porositë e duhura në mënyrë që të plotësojë nevojat e produkteve sipas kërkesave të klientëve.
- Mban dhe konsolidon marrëdhëniet me furnitorët për të arritur cmime konkurruese në blerje dhe terma më të mirë komercial;
- Bën kërkime të vazhdueshme për furnitorë të rinj që plotësojnë nevojat e biznesit;
- Harton strategji afatgjata për zhvillimin e kategorisë që mbulon;
- Harton strategji për eliminimin e stokut të vjetër (të pashitshëm);
- Analizon raportet e brendshme për të përcaktuar trendet e industrisë dhe sjelljen e konsumatorit;
- Bashkëpunon ngushtë me dep. e shitjes për të përcaktuar cmime konkurruese dhe aktivitete promovionale.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare, **Domosdoshmëri Inxhinieri Elektrike/Elektronike etj;**
- **Eksperiencë pune e mëparshme në shitjet me shumicë dhe/ose pakicë.**
- Njohuri të mira të gjuhës Angleze;
- Të njohë mirë Microsoft Office;
- **Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe negocimi;**
- Të dijë të marrë vendime dhe të ketë etikë të lartë profesionale.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutem dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.